



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.10.2018, ora .10.00:...

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri -Kosovë, alokimet e vitit 2016”.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodjana Spahiu, Sadri Abazi, Egllantina Gjermani dhe Andrea Marto.

Mungojnë: Genc Pollo, Aldo Bumçi, Vangjel Dule, Taulant Balla, Grida Duma, Jorida Tabaku, Klajda Gjoshja dhe Viktor Tushaj.

Të ftuar:

Genti Cakaj - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi - Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, për alokimet e vitit 2016”.

Fjalën e ka zëvendësministri. Ju lutem, shkurtimisht.

Genti Cakaj – Pak a shumë marrëveshjet kanë të njëjtën natyrë, ndryshon vetëm bashkëpunimi ndërkufitar që është me Malin e zi. Korniza ligjore është respektuar maksimalisht. Marrëveshja e financimit është miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 792, më 21 dhjetor të vitit 2017 dhe nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Ditmir Bushati, më datën 29 dhjetor të vitit 2017, prandaj në kuptimin e fundamentit ligjor çdo gjë është e mirëvendosur.

Efekti financiar i kësaj marrëveshje konsiston në një shumë prej 1 milion e 700 mijë eurosh, që do të jepen në formë granti nga Komisioni Europian. Qeveria shqiptare në bashkëpunim me qeverinë malazeze do të kontribuojnë në tërësi me 300 mijë euro, kjo do të thotë që fondi në tërësi është 2 milionë euro. Vlen të theksohet që përfitues të këtij programi do të jetë një pjesë e njësisë territoriale në Malin e Zi, po të doni jua them edhe emrat, ndërsa për Shqipërinë përfitues të këtyre projekteve do të jenë qarqet e Shkodrës dhe Lezhës. Destinimi financiar që vjen nga ky financim është i njëjtë ashtu siç është në marrëveshjen me Kosovën, respektivisht shkon për nxitjen e turizmit, trashëgimisë kulturore, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e punësimit dhe lëvizjen gjeografike të punonjësve.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

A ka pyetje për këtë projektligj? E njëjta pyetje dhe e njëjta përgjigje vlen edhe për këtë projektligj, prandaj do t’i bëjmë një letër qeverisë për të ngritur këtë shqetësim.

A ka diskutime? Nuk ka.

Edhe për këtë projektligj shërbimet kanë bërë relacionin përkatës dhe është i njëjti konkluzion, pasi projektligjet kanë pak a shumë të njëjtën natyrë, ndryshojnë vetëm shtetet që bashkëpunojnë.

Sipas traditës dhe rregullores së funksionimit të komisionit, ne duhet të miratojmë relacionin për t’ia dërguar komisionit përgjegjës.

Kush është dakord me relacionin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E fundit, kemi disa njoftime për komisionin. Autoriteti i Aviacionit Civil ka kthyer përgjigje për shkresën që i dërguam ne për sqarime. Sekretaria e komisionit jua ka dërguar me *email*. Nëse keni nevojë për sqarime të mëtejshme, në mbledhjet e radhës mund të thërrasim një përfaqësues nga Autoriteti që të na sqarojë.

Njoftimi i dytë, edhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka dërguar raportin tremujor për ecurinë e procesit të integritetit. Raporti është përcjellë sot në mënyrë elektronike në adresat e deputetëve, prandaj duhet ta lexojmë, sepse do të kemi edhe një seancë për këtë raport.

A ka diskutime për çështje të tjera? Nuk ka.

Këtu mbyllet edhe mbledhja për sot.

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

SEKRETAR

Fatmir Velaj

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Valbona Noli (Collaku)